



PRANIMUAR
ACCEPTED IN
PRIMALJENI

30.06.2025
02/195



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës

Nr.02/

Date: 30.06.2025

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 pika (d), nenit 24 paragrafi 1, nenit 40 paragrafi 2 pika (c), të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), nenit 2, nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27/03 qershor 2008"), nenit 19 të Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit i plotësuar/ ndryshuar (neni 80), ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27/03 qershor 2008"), bazuar në nenin 13, nenin 23 paragrafi 7 pika (b), nenin 42, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.02/441 datë: 14.09.2023, kërkesën nr.04/326/ datë: 30.05.2025 të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e dytë të jashtëzakonshme e mbajtur me datë: 30.06.2025 merr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE TË KOMUNËS SË
MALISHEVËS 2026-2028

1. Miratohet Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Malishevës (KAB) për vitet 2026-2028, me theks të veçantë, për vitin 2026 e përcaktuar nga Ministria e Financave, Transfereve dhe Punës.

2. Korniza Afatmesme Buxhetore për vitin 2026 përmban këta kufij buxhetorë:

Paga dhe medetje	13,145,020.48€
Mallra dhe shërbime	2,555,812.48€
Komunali	500,000.00€
Subvencione dhe transfere	600,000.00€
Investime kapitale	5,266,999.04€
Totali:	22,088,710.00€

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Malishevës (KAB) për vitet 2026-2028.

4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, nenin 9 të Ligji nr. 08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:

Arkivit të Komunës

Drejtor të Drejtorive Komunale

MAPL-së

Kryetari i Kuvendit
Argjend Thaci

